



Prishtinë, 03 tetor 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_843\_2016

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenin 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, dhe Nenin 32 paragrafin 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 7, Nenit 18 paragrafi 3, Nenit 24 dhe Nenit 32 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 11 paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, (Ligji Nr. 03/L-043),
- Aplikacionin për vazhdim të licencës për prodhim të energjisë elektrike të bërë në ZRRE me datë 04.04.2016 nga ndërmarrja Korporata Energjetike e Kosovës –Divizioni i Gjenerimit “KEK SH.A.”-TC Kosova “A”, adresa: rruga “Nënë Tereza nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
- Kërkesën për shtyrje afati të licencës për prodhim të energjisë elektrike për TC Kosova A, e datës 04.04.2016; dhe
- “Njoftimin për aplikacionin për marrjen e Lejes Mjedisore të Integruar”, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me Nr. Prot: 579-2/16, të datës 25.03.2016;

në seancën e mbajtur me datë 03 tetor 2016, nxori këtë:

### VENDIM

- I. **VAZHDOHET** licenca për prodhim të energjisë elektrike Korporatës Energjetike të Kosovës – Divizioni i Gjenerimit (KEK SH.A.)-TC Kosova A, me numër licence ZRRE/Li\_05/13\_A, për periudhën nga **04 tetor 2016** deri **04 tetor 2017**.
- II. **Obligohet** KEK SH.A. që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të këtij vendimi të sigurojë Lejen Mjedisore të Integruar nga MMPH, dhe kopjen e së njëjtës ta dërgojë në ZRRE.

### Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 04.04.2016 ka pranuar nga KEK SH.A Kërkesën për Vazhdim Licence për prodhim të energjisë elektrike të KEK Sh.a. – Divizioni i Gjenerimit”-TC Kosova “A” për periudhën nga 04.10.2016 deri me 04.10.2020.
- KEK SH.A po ashtu ka dorëzuar Aplikacionin për vazhdim licence për prodhim të energjisë elektrike dhe dokumentet/dëshmitë e kërkuara nga ZRRE për Licencim të këtij aktiviteti, përveç Lejes Mjedisore të Integruar (për të cilën ka dorëzuar Njoftim nga MMPH).
- Në pamundësi të nxjerrje së Lejes Mjedisore të Integruar, Bordi i ZRRE-së që nga viti 2011 për çdo vit i ka vazhduar licencën për prodhim të energjisë elektrike ndërmarrje KEK SH.A-TC Kosova A (vendimet për vazhdim licence: V\_380\_2011, datë 30 shtator 2011; V\_437\_2012, datë 01 tetor 2012; V\_556\_2013 datë 06 shtator 2013; V\_652\_2014 datë 03 tetor 2014, dhe



V\_749\_2015, datë 16 korrik 2015), duke obliguar të licencuarin që brenda periudhës së përcaktuar në pikën një (I) të dispozitivit të Vendimeve, ta sigurojë nga MMPH Lejen Mjedisore të Integruar, dhe një kopje ta dërgojë në ZRRE.

- Pas çdo aplikimi për vazhdim licence, KEK ka dorëzuar në ZRRE një Njoftim të lëshuar nga MMPH lidhur me Lejen Mjedisore të Integruar.
- Me kërkesë të ZRRE-së, e po ashtu me qëllim të përmbushjes së dispozitave të licencës dhe obligimit të përcaktuar në vendimin V\_749\_2015, gjatë këtij aplikimi për licencë KEK SH.A ka bërë kërkesën në MMPH (me datë 12.02.2016 me nr. protokoli 579/16) për marrje të Lejes Mjedisore të Integruar.
- Në Njoftimit e MMPH-së të datës 24.03.2016 thuhet se: *MMPH ka pranuar aplikacionin për Leje Mjedisore të Integruar dhe është duke e shqyrtuar lëndën në bazë të Ligjit për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, (Ligji Nr. 03/L-043), ku Neni 11 i këtij ligji parasheh që të gjitha impiantet ekzistuese, në këtë rast KEK-u, duhet të harmonizohen me kërkesat që përcaktohen me dispozitat e këtij ligji jo më larg se 31 dhjetor 2017, duke marrë parasysh Planin e propozuar të Orarit të Përputhshmërisë për atë impiant. Duke u nisur nga fakti që zbatimi i dispozitave që dalin nga ligji i lartpërmendur kërkojnë një analizë të thellë të gjendjes teknike të instalimeve të KEK-ut, që paraqesin një kompleks të madh industrial por edhe me një vjetërsi të konsiderueshme, do të kërkohet një bashkëpunim i ngushtë me KEK-un për të planifikuar mirë kohën e plotësimit të kushteve për përmbushjen e standardeve të përcaktuara me legjislacionin për mjedis. Pas shqyrtimit të raportit dhe plotësimit të kushteve të parapara në nenin 9 të ligjit Nr. 03/L-043, MMPH do të lëshon vendimin për Leje Mjedisore të Integruar.*
- ZRRE duke marrë parasysh këtë që u tha më lartë, dëshmitë e bashkëngjitura aplikacionit për vazhdim licence dhe sipas dispozitave ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.





Vendimi i dërgohet:


- Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK SH.A) TC Kosova A
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së**

  
Krenar Bujupi, U.D. kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Qemajl Mustafa, anëtar